

214 - 1

A. 85

vajzat dhe  
dallëndyshe

- Ali Cullani -



891.983-1

A.85

ALI ASLLANI

S

VAJZAT

DHE

DALLËNDYSHET

~~34853~~

BIBLIOTEKA E SHKOLLËS  
GJIRKASTËR

11 381

## MYZEQEJA DJE DHE SOT

Një dikush në Myzeqe  
paskish lindur me këmish,  
kish e kish e, çfar' nuk kish?  
nja dymij pendë qe!

Dhe një tokë përrallore  
sa nuk kish një mbretëri,  
sa nuk kishte tok' pjellore  
atë kohë Mali Zi!

Kurse bujku myzeqar,  
derëzi e punëzi,  
kishte tok' sa një harar,  
ajo pjesë që ish pjellore,  
ish sa është' një shami dore!

As gjë tjetër, as gjë tjetër,  
Veç një gjym mbi tym në vatër,  
veç një gjym të zi mbi vatra  
dhe një këmbë nga të katra,  
një këmb' kau, një këmb' viçi,  
me një fjalë: hiç bir hiçi!

Pasuria arbërore  
s'i përkiste kurrë krahut,

vetëm njerzve të oborrit  
në shërbim të padishahut!

Këta lindin duke patur  
nënë sjetull pend palloj,  
nam i tyre s'kish të matur  
vënd më vënd, e goj' më gojë!

Dyqind muaj edhe t'hu  
urdhëron një ligj i ri:  
në atdheun tonë, këtu,  
djers' e ballit është' flori!

E kështu ja nisi kënga  
këng e gunave pa mënga:

Tok e vëndit përgjithmon  
është e krahut që punon,  
s'ka më vënd për jotja, imja,  
atë llër' që nuk punon  
lëre, le ta haj qimja!

Më nuk mbeti rob' e zot,  
shkoi e vate ajo famë,  
tash me hyjë, fuqiplot'  
u bëm' fit dhe u lamë!

## THUMANI

Midis Shkodrës e Tiranës  
ka pas' qën' një vënd pusie,  
ku ndokush, nga an' e anës,  
nga përroj i rrept' i thanës,  
vinte ripte veresie!

Vinte vriste, vinte ripte  
dhe të gjall' në grop' i kripte.  
Aty s'kishte veç pusira  
dhe strofka për egërsira!

Strofkë ujku dhe çakalli,  
ku nuk bënte gëk i gjalli,  
zonj' e vëndit ishte miza,  
lule vëndit ishte driza!

Ja, ky ish Thuman i vjetër,  
me një popull shtypur tepër,  
dy shtëpira me një tra,  
pika kohës që s'i ra!

Po tani Thumani ri,  
u bë ferm' për bukuri!

U bashkua llëra, truri  
dhe ja nisi polli guri,  
polli guri kalli gruri,  
epopen e bujkut thuri,  
mbill purri dhe korr flori!

Dhe sa vete po qëndiset,  
po qëndiset e pajiset,  
me të gjitha gjat' e gjërë,  
që nga filli në gjilpërë!

Dhe do bënet tani afër,  
jo qytet, qytet i varfër,  
po qytet për kok' të vet,  
mot e jet' me plot shëndet!

*Nëndor, 1961*

## SHKOI KOHA E PALLASKËS

Polli guri kalli gruri,  
kalli gruri polli guri,  
hallëxhesha, që dikur,  
mbetur kish kock' e lëkur,  
epopera trimi thuri!

E u nis e u stolis,  
yll në ball e armë në bel,  
di t'a shtrydhi dhe një plis,  
di dhe zoqtë që t'i mjel,  
di nga lulet të heq sis,  
e kështu, i dashur shok, na u bë rigoni  
lis!

U bë lis edhe rigoni  
s'ka përse të qahet gjoni:  
u bë zot i kësaj toke  
të ushqyer me brum baroti,  
të ushqyer me kocka koke,  
të gatuar me pika loti!

U stolis me një kulturë  
vret dy zoq me një gur,  
bëri ç'bëri sa që tash  
edhe delja pjell pa dash;



kreu mjalt nga lëpushka  
na u bë më pot dhe mushka!

Edhe llër' e hollë e vajzës,  
burazerkës me gjëlpërë,  
që kalon përmes unazës,  
edhe kjo, i dashur mik, ka dyfish  
fuqira krahu  
sa e bën e lëshon lule edhe bririn e një  
kau!

Briri kaut lëshon lule,  
mu si drita në kristal,  
këto llëra deg bilyri,  
zot o zot të qofshim fal,  
gjetën vëndin e grabitur  
brënda nderit tonë të situr.  
e u bën pronare svri!

Shkoi koha e pallaskës.  
që e gjora grua rrihej,  
dhe për qejfin e laraskës;  
ajo kohë mëkatare  
e pat quajtur femrën pronë,  
tashti kjo u bë pronare  
dhe do mbetet përgjithmonë!

Mos më qesh, i dashur shok,  
me rromuze me mëzmëze,  
nuk është keq, mor tungjatjeta,  
të jeç pron' e një thëllëze!

## KUJTIME TË VJETËRA

### (Fragmente)

#### I

Kur rrok armët një shqiptar  
dhe bën luftë për liri,  
pushk' e tija vete mbar,  
rroftë nëna Shqipëri!

Vajti mbarë sa nuk pandehëm,  
na e mbushi sa u dehëm,  
pra, na dukej si një pëndë  
edhe barra më e rëndë,  
dhe po turrehim të tërë  
fron' e mirë kush ta zërë!

Dhe aty filloi e zeza,  
njëri thosh: un' e ndeza  
këtë dritë dhe, pothuaj,  
jam i zoti që ta shuaj!  
Tjetri thosh: shumë më parë  
dora ime hodhi farë!

Si gjithkush ato të tijat,  
grindej nëna me të bijat,

njëra vjen e tjetra vete  
si gjithkush: «kërkoj për vetel!»

Kurse burri më i mirë  
ish' ai me gun' të dhirë,  
ish' ai heroj i thjesht,  
mos e quaj se vëndi hesht!

## II

Ideali që ke ti  
është' e ditur, si e si  
që të bënet Shqipëria  
bash mbi pemë zerdelia!

S'ka dyshim, po, ke pengime,  
do keç mbase dhe mjerime:  
më shum' leqe nga të liqtë,  
se pengime nga armiqtë!

Pra, do diç e t'u bësh ballë,  
shih vaporin kur bën valë,  
kur bën det edhe valon,  
se sa bukur udhëton!

Kurr më vala nuk përfytet,  
mbasi ruhet se mos mbytet,  
asaj vale i bën anë,  
këtë tjetrën vjen e çanë,  
aty dridhet, aty kridhet,  
këtij krahu vjen e hidhet!

### III

Shqipëria, yll o yll,  
po dhe yjet paskan pyll,  
paskan gjëmbe e gjërpinjë,  
paskan tenj' e paskan lenjë!

Shtriga dhelpër, si një mike,  
i di mir' këto furije,  
do na vej e do na vij  
mu si nëna në fëmijë!

A i di ato fytyra?  
Ato shtriga të palyra,  
ato bënen dyll e brumë,  
bënen val' e bënen shkumë,  
bënen maçe. bënen mi,  
bënen mollë për në gji!

Trim' i mir' me shokë shumë,  
do të thonë ty, dhe ti,  
me një farë madhështi,  
do t'i vesh në një radhë,  
radh' me burra faqebardhë;  
kur nderonet një i lik  
është' i miri në rrezik!

### IV

Di i ligu, bënet rob,  
ti do thuash e kam në dorë,  
e kam pushk' dhe e kam top,  
në çdo rast e në çdo orë!

T'u bë ujku shok shelek,  
nënë sjetull gjeti shtek  
dhe ja, ja, t'u fut në vatër,  
të dy sytë bëni katër,  
i këqiu, kur gjen streh,  
kërkon raste që të leh!

Do të lyej e do të laj,  
njërin mburr e tjetrin shaj,  
në ke fron po, natyrisht,  
ti do jesh i madhi Krisht!

Lajkatarët... lajka shtriga,  
plag' e ligë mbi të liga,  
dallkaur e dyfaqarë  
spor' e popullit bujarë,

Para syve vin' të krehën,  
prapa krahve zënë e lehën;  
gjithë ditën puthin pragje,  
gjithë natën kruajn magje!

## V

Ti nga thash' e themet ruhu,  
sa më shumë dua j e duhu,  
jo me ar në gemer,  
jo me barqe plot me vrer,

jo me dhunë e me përdhunë  
me fudulla, un' mor unë!

po me guna rrahur vese  
dhe me ballë plot me djersë.

Me të djegurit nga dielli,  
me ata që u qan fyelli,  
që pran' zhgabës dhe për zhgabë  
i shkretojnë nën' e babë!

---

**SHËNIM:** Poema «Kujtime të vjetëra», prej së cilës botojmë disa fragmente, është shkruar në vitin 1921 në formën e këshillave për brezin e ri, i cili duhej ta shihte çdo gjë nën prizmin e interesave t'atdheut dhe të mos binte në kurthin e të liqve dhe armiqve.

## DI TA MUNDI VDEKJEN

Në një spital vete,  
Ashtu e kam hall  
Sado jam me derte  
Syt' që kam në ball'  
Un' i marr me vete,  
Që ta shoh më mirë  
Luftën e vështirë!

Dhe e shoh përpjekjen,  
Sa që syt' më meken;  
Më flet vetëdia:  
Ja se si Partia  
Di ta mundi vdekjen!

Edhe do ta mund'  
Ky vigan vullnet s'ka kufi, e fund!  
Zoga zoq doktorë  
Në detyr' therorë,  
I mjekojn' të gJORët,  
Edhe i rilindën;  
Nënat tash u bindën,  
u ringjall' dëshmorët!

## NA TREGON NJERIU I VJETËR

Na tregon njeriu i vjetër:  
Kur në krye kishim mbretër,  
Kishim mbretër e sulltanë,  
Muhabetet anembanë,  
S'ishin tjetër, asgjë tjetër,  
Veçse lajme shum' të majme,  
Mbi një bot' të paskëtajme,  
Mbi parajse përtej qiellit,  
Më përtej nga heli diellit,  
Plot me zana, me hyrira,  
Gushëkuqe farfurira,  
Shumë t'ëmbra e majhoshe,  
Zot o Zot, të qofshim fal', mot e jetë dyqind  
muajshe!

Dhe të tjera muhabete rreth lejlekut këmb'  
dybekut,  
Kush i bën me boj' të kuqe të dy këmbët e  
lejlekut?  
Kush e ruan nga lagështira agëzosin e dyfekut?  
Dynjallëk, mor tunjatjeta, kush e kush e s'ka  
të sosur  
E ç'na duhej muhabeti rrotull shkencës së  
marrosur?!

Dhe ajo që na sjell ujë në mulli të millonajt



Qënkesh vetëm edhe vetëm fjal' e urt' e një  
mullajt.

Jo mulla e çdo mulla, po një kryexhevahir,  
Që në orën e vështirë  
Na ish bër' çadëre koke në të liq e në të mirë!  
Sepse frym' e tij mistike u bë shpres' e të  
sëmurit!

Ai dinte ta çdukë ethen,  
Si një çap që e nduk gjethen,  
Ky e kapte, e mbërthente me një gozhd' në  
mes të murit!

Ashku i qiellit e kish prekur,  
Sadoher që vjen e vete,  
I pëlqente vazhdimisht të llafosej vetmevetel!  
Dinte gjuh' mullai ynë sa llafosej me të vdekur!

Tash pllakosi shkenca shtrigë,  
Nanurisjet i pushoi,  
Çdo e mir' u bë e ligë,  
Qielli burxhin e ndryshoi!

Vate briri i berberit,  
Që na merrte gjak në vetull,  
Tani vjen infermieri,  
Na ngul gozhdën nënë sqetull! 1)

Dhe ilaçi dy-tri gota  
Dy-tri gota, fund' i fjalës,  
Tromobili pret te porta  
Nuk ec këmba, ecën rrota,  
Jazëk humbi kal' i shalës!

---

1) Termometri

## VAJZAT DHE DALLËNDYSHET

Në vjesht' dielli nuk të djek,  
pik 'e vesës lot pikon,  
duket fleta që u prek,  
duket flladi që rënkon!

Sapo vete qielli vrejtet,  
si një sy që u rrëmbush,  
si një vashëz që po rrejtet,  
s'di sesi dhe s'di nga kush!

Lere qiellin që të vrejtet  
sipas hënës që e zuri,  
Po jo vashën që të rrejtet  
kur bën dorza kalli gruri!

Vajz' e vendit kalli are,  
në pun' ngrihet shumë më lartë  
dhe nga zjarri më e zjarrtë,  
rroftë vashëza shqiptare  
dy her' ar kalliri artë!

Dashuria tungjatjeta  
midis çiftit të selitur  
dhe me besën ton' të situar,

34853  
11381

ësht' e ëmbël shumë e shkreta,  
ësht' gosti nga qielli zbritur!

E do vajzën? i thuaj: eja!  
një çift kitel<sup>1)</sup> na mjaftojnë,  
dhe në vjesht' kur varet reja  
dallëndyshet udhëtojnë!

Dallëndyshet edhe vajzat  
vin' e rrjedhin nga një derë,  
në vjesht' shkojnë këmbejn' unazat  
kthehen çift në paraverë!

---

1) Kite — dorëza kalli gruri të njoma, që përcëllo-  
nen në zjarr dhe hahen po ashtu si misrat.

## SHPELLA E BLETËS

Në katundin Vajz' të Vlorës, më tej bregut  
Allatojt,  
kurse nise për në Ploçë, më të djathtë, rrëz'  
përrojt,  
ka pas qen' një shpell' e madhe,  
dhe mbi sup të saj Beuni, rreth me pyje plot  
sorkadhe.

Shpella quhej Shpell' e Bletës, me një maj' si  
thik e prehur  
ledhe-ledhe hoje mjalti kish në gjin' e saja  
fshehur  
Ledhe-ledhe hoje mjalti, mbasi bletët me kopera  
aty hynin edhe dilnin që nga koh' e lasht',  
përhera.

Vëndi yn', si Shpell' e Bletës, dhe si nën' e  
deli nënë,  
ruan në gji të tija brenda mjalt' e qumësht,  
domethënë  
pasuri të radhës parë, pasurira që pothuaj  
deri tash i kish rrëmbyer një gogol, një dor'  
e huaj.

Dikur hahej bot' e vjetër për jorgan të Nas-  
tradinit,  
pasuri e Shqipërisë quhej mall' i beduinit!  
Mall në duar të gogolve dhe kafshit' për goj'  
të ujkut,  
por tani, mor mik i dashur, është' i krahut dhe  
i bujikut.

Është' i bujikut, i bariut,  
I atij që ja fshin djersën dor'e freskët e veriut!  
Është' e popullit shqiptar,  
pik' e djersës e të cilit vlen sa vlen një kup'  
me ar

## DYQIND MUAJ EDHE T'HU

Dyqind muaj edhe t'hu  
në Shqiponjën Shqipëri  
lulëzon lastar' i ri,  
treqindmij' të ri flori!

Ish një kohë po këtu,  
gjith' shkollarët e një shkolle,  
mu si kecër në kasolle,  
mblidheshin ashtu kështu  
rreth e rrotull një rrogozi,  
me një koll' tuberkoloji!

Pasandaja s'dim si ngjau,  
u tund briri i një kau,<sup>1)</sup>  
përmbi bririn e këtija,  
ngrinte botëra perëndia!

Tani vate ajo botë  
me gjith' kaun fuqiplotë,  
tej për tej u shëmb e ra  
bashk' dhe shkolla me një tra.

---

1) Sipas përrallave të vjetra nën dhe paskish një  
ka dhe lëmshi i dheut qëndronte mbi bririn e  
këtij kau!

Tash po hipim posht' përpjetë  
për t'u bërë shtetas dielli,  
me të njejtin vrull që zbret  
kjo rrufe e rrept' nga qielli!

Kjo rrufe... po shkoll' e urtë  
shkoll' e re mësues i ri  
shpejt a von' me dhëmshuri  
dhe rruferat do t'i zbutë!

## NUSJA QË DO HALLA 1)

Nusja, nuse pullumbeshë  
na u vesh e na u ngjeshë  
me ato që hane hane  
vishen hankot hanedane,

me ato gazep tumane,  
me xhanfes e me atllase,  
një tumane shtat' tallaze,  
shtatëdhjet e shtatë naze!

Përmbi supe një kaftan  
gjith' inxhi e gjith' merxhan  
hipur kalit qyhejlan,  
përmbi shalë gjith sadefe  
të qëndisur me gjergjefe  
e përçuell me dyzet defe,  
dhe me katërqind kalorës  
niset bij' e rënd' e Vlorës!

Paj' e saja teste teste  
nga takija gjer në meste,  
që nga mestja në takije  
njëzet vargje mahmudije,  
kollonata, mexhidije.,  
mexhidije, kollonata,



Burri do ta doj', vjerra do ta doj',  
po që të mos merret nusja nëpër goj'  
duhet të flas fjalën me perde, si thon',  
pse i pritet koka pulës që këndon!

Në rrofsha e qofsha dasmën do ta tund  
Qejfin gjër në maj, harxhën gjër në fund;  
Dhe kismet nga zoti, pse nashti nuk takset,  
Shëndosh e gëzuar bota do patakset!

Dy pëllëmb e gjysëm do bëj bakllavat,  
Do dërgoj t'i qepte rrobat në Berat! 2)  
Disa në Berat, disa në Janinë,  
amin e amin, dhe që thua tinë.

dy kuti kënah, tri kuti mazi,  
pes mexhide kutin, një çarçaf të zi.  
xhanfes e atllas, të tjer' e të tjera  
si e ka zakonin dera jon' përhera.

Katër pash e gjerë çelur port' e madhe,  
gurabit' me teste, samsa ledhe ledhe,  
si të duash moj motër, haje, piqe, derdhe!  
Llokume Stambolli për far e për fis,  
rrofshin e burofshin', dy grushte oris!

---

1) Kujtime nga 1890-1900.

2) Berati ishte qendra e prefekturës.

## NJË ALTAR I MADH SHQIPTARI

Një dit' plasi një rrufe  
përmes heshties më të zezë,  
vren i madhi Halife,  
ishte klithma e një shpirti  
që shpëton nga një varrezë!  
Ishte klithm' e një petriri,  
që shpëton nga një kafaz,  
ishte plasja e një shpirti  
buhavitur në maras!

— Zot o Zot, vall', si ka ngjar'?  
— Shkeli bukën një shqiptar,  
e guxoi e ngriti dorë  
kundër fronit më qiellor,  
fron i njëqind halifeve,  
sundimtarit të rrufeve!

Ismail Qemali iku,  
nga qyteti mbi shtat' kodra!  
— Po si iku, si vallë iku?  
— Si një yll që u këput.  
Nga Stambolli gjer te Shkodra  
pushoi fryma një minut!

Pak më vonë ra mëngjezi;  
kur në vatra të shqiptarve,  
me urorin e të parve,  
dor' e nënës zjarr' e ndezi,  
rreh një tel:  
e kaloi Dardanel!

Hasmi mbet me duar në mes:  
po, në ball të çdo shqiptari,  
atë ças një yll u ndes!  
Në minut' që dolli ylli,  
dolli sorkadhi nga shtrati,  
pushk' e penës iu çel fati!

Nuk ish fati që e gjeti  
ishte duf i një tërmeti,  
ishin burrat e barotit  
në atdhe të Kastriotit!

Mbi të gjitha, besa-besa!  
arma jon' me shtatë presa,  
ishte besa e shqiptarve,  
amaneti i të parve!

\* \* \*

Ah ky fis, ky fis, ky fis  
nuk pranon as hie shpese  
që t'i bjerë mbi kurris!  
Dyzet shekuj fis këmbor,  
dyzet shekuj fis ballor,  
hekur nduk dhe un' e zhduk,  
po nuk ulet, nuk e nuk,  
që të heq nga dosa sisë!

Qyq më deg' është, derri-derrit,  
as bën vithje, as bën mes,  
një her' len, po dy her' vdes;  
Edhe di për fjal' të nderit  
di të krejë krip' e bukë  
dhe nga qiellza e sqyfterit!

Sado bie, po nuk tundet,  
mund të vdes, po kurr nuk mundet,  
e vdes vdekja, po s'e shëmb,  
e pret mortjen këmb' mbi këmbë'!

Edhe gropën e një varri  
e pranon si dyshek ari,  
ha inat e ha inat,  
mot e jet' sahati shtat'!

\*\*\*

Ky është' burri arbëror  
me një çift rrufe në dor',  
me këta u bë që tash  
kjo shqiponja Shqipëri  
përmbi shoqe dyqind pash',  
u rilindë përsëri!  
Për Ismail Qemalin bash  
po ngre kupa rreth flori,  
dhe po ngreh një përmendore,  
duk'e ngjeshur me aik' ari,  
në kërthizë të asaj Vlore  
në faltoren arbërore,  
një altar të madh shqiptari!

## FSHATI VAJZË

Në krye të fshatit ka një deli krua  
uj' i tija akull derdhet në përrua:  
dhe në krahuri tjetër varet nga një mal  
një përroj i rreptë me shkum' e me vall

Mu në mes të tyre bregu Allatoj  
dhe shtëpit' e fshatit si fole fajkoj;  
fshati gjyshit tim, fshati më i mirë  
nga ato që thuhën: Labëri e lirë!

Aty përmbi shkallë po gjëmon dybeku.  
aty nënë shkallë blegërin shelegu;  
rreth e rrotull lëmit djemtë heqën valle,  
nënë rrap, në hije pleqtë qajnë halle!

Lahure qëndisur bedene bedene  
seç i paska hije asaj protoene;  
nusia protoene me një furk në sätull  
të ther e të gris me sy e me vetull!

Andej disa koce shkoinë për në krua  
këtej bagëtia varet në përrua;  
me kërrab në dorë një dylmer djalosh  
përmbi sy kesulën sokëllin përposh!

Edhe zilet zjejnë, zile dhe zambare  
ta shërojnë xhanin pa një pa dy fare,  
pa le ajo zile, zil' e deles rudë,  
ajo zil' e shkretë në mes të këputë!

Dimrit nëpër fshatra, verës nëpër stane  
e çkërkon më mirë në këtë jallane?

Pleqtë qajnë halle: ah kjo avr' e ligë  
është dreqi jugës, është juga shtrigë,  
kurse reja duket mu në maj te lisi  
një me një demek edhe shiu nisi!

Qoftë nënë ujë qoftë serikoj  
vjen e hardalloset, ç'e rrëfen me goj!  
Vjen e hardalloset, xhano ta ka ënda,  
këmbën përmbi këmbë, dyqint qase  
penda!

Të korr e të shirë sosen gjith të mjelët  
Gusht e gushtovjesht sosen gjith' të  
vjelët

papo zën e mbaren, magje e çetur,  
Kazan e kënaçe, ç'paska në ahur,  
shatin e lopatën, talër e kusinë  
gjithë prokopinë, në një krah të mushke.  
dhe në krahun tjetër thasët e lëpushkës,  
mbasi dy tri herë mushkës i bërtiti,  
fill e flak' si thana mu ndë fshat arriti!

Lab mor tungjatjeta, s'ka më shum'  
nevojë,  
ky punon për nam, nuk punon për gojë,

s'ka sevda për leka, s'ka sevda për  
grosh,  
nuk e ha meraku për gjë e për llosh,  
po kur ja do puna, di sa derr' i derrit  
di e kren kafshitën nga sqep' i sqifterit!

Dimrit nëpër fshatra, verës nëpër stane  
e ç'kërkon më mirë në këtë jallane?

## II

Të korr e të shirë sosën gjith të mjelët  
gusht e gushtovjesht sosën gjith të vjelët;  
mirpo këng e vallet, ato nuk u sosën,  
kemi hair sile, dy vet' po qinosen,  
dhe nja dy të tjerë, bënen burazer,  
me një dash të pjekur dhe me dy  
hyshmer  
disa bënen kumtër, disa bëhen krushqë,  
disa zun e hapen ata brigje dushqë!

Papo miq' e shokë, rreth e çet thërriten,  
me sa u dha zoti bukur do gostiten;  
kënga do gjëmoj, valle me kobure,  
dhalla me kënaçe, gjalpi me çeture;  
po s'iu ngopet xhani me mish e me  
dhjam  
duhet që t'ja bëj dhe dyfeku bam!  
Labëri mor mik, këto vënde zoti  
deshi dhe i ngjeshi me tule baroti!

Diku edhe pleksen, edhe pleksen rëndë,  
ato vakiate zoti mos i dhëntë;

pa dëgjoni plakun, plakun e mëhallës  
ngulur këmbë kryq në sofa të shkallës  
thotë: aty lasht, lere ti haj ujku,  
kur po bënin luftë Junani dhe Turku,  
një i pjell i dreqit, përtej në lëndinë  
Koces e Meçanit i hoqi shaminë!  
papo rrudhi fshati për një bishëkorrë  
u vran e u therë deshët me këmborë!

Gjan që edhe pleksen më shum' a më  
pak,  
jo ti je vandak, jo un' s'jam vandak,  
me gjith' këto halle dhe sado të pleksen  
goj' e tyre s'thotë fjalë që s'honepsen;  
ndryshe bënu burrë, se të zë e zeza  
labi ta merr fjalën që pa dal nga qiellza  
Papo quatinë për atë ugar  
dhe për atë lëmë dreqi të ka marr!

Labëri mor mik vend i çepezive,  
ta humbasën gjurmën, në gjurma te  
dhive,  
pra sido të gjaj arbreshi arbreshit  
dhe kur i vërsulet, i vërsulet sheshit!

Dhe sido të gjaj aty nënë tëndë  
mblidhet pleqësia që të mbaj kuvendë,  
po aty gjykonet halli sido sosit,  
po aty vendoset cili do kanoset!

Lab mor tungjatjeta, labi është i lirë,  
ja thyen si i teket, si e quan më mirë,



nuk e pengon guri, nuk e pengon  
gardhi,  
ai është rritur me mëlçi sorkadhi!

Ja heth e ja thyen, ja thyen e ja heth  
merre si ta marrëm në leth e mbi leth,  
ashtu i do xhani, ashtu i pëlqen  
ashtu e ka gjetur den-baba-den!

Ashtu e ka gjetur den-baba-den,  
aty edhe dielli matet me hosten,  
një hosten më poshtë, një hosten më  
lartë  
kohën e këndojnë si kadi në kartë!

Shenjezit kur duken, majës fill e flak.  
është mez i natës, një mëllë me pakë,  
kurse duken rrallsit, rrallës e të tjerë,  
thuj se ra mëngjezi, nata fare thyer;  
ky yll del me kaq, ai del më aq  
Deh mor fshat i gjyshit sa të dua kaq!

## TEPELENA

Në minut' që doli ylli  
doli sorkadhja nga pylli,  
Doli sorkadhi nga shtrati  
Tepelenës iu çel fati!

Tepelenën tungjatjeta  
e mallkoi Demir Hani  
e përqeshi gjoja xhani;  
pra ja nisi tatëpjeta  
dhe s'i mbeti nam nishani,  
nga nishanet e qëmotit  
të Ali Pasha barotit!

Vënd i burrave bajrak  
burra, gjith' pa zorr' në bark,  
midis shkëmbit edhe lumit  
të ha dreket dhëmbi plumbit!

Suferina më e marrë,  
më i egri murrëri,  
s'kalon dot po hiqet zvarrë  
nëpër gjurma të një drëri!

E kështu, i dashur shok,  
sidomos me osmanlli,  
kan dhën' kok' e kan' marr' kok'  
e u bënë fermanlli!1)

Po nuk bëri prokopi  
sado rreth me lënd' e gur,  
nëntëdhjet' e nënt' shtëpi,  
nuk e mbushi qindin kurrë!

\* \* \*

Shko, më thon' — edhe shiko  
Tepelenën ton' trimoshe,  
shko dhe syrin tënd e ko  
dy pallate në një qoshe!

Sa për vëndë, ai vëndë  
rrotull malet gur ergjëndë,  
gjelbëruar me pem' e pisha.  
Vetëm s'paska më dervisha,  
pa kësul' e pa këmisha!

As dervisha, as dervishe,  
po ka shegë devedishe,  
Devedishe Tepelene,  
edhe bejka protoene!

Dhjetor 1962

---

1) Shprehje ligjore turke (gjall-vdekur kapet dhe pushkatohet)

## PO KRIJOJ NJERINË E GJALLË

Mosh' e re  
përmes kohës më të re,  
u shkëput si gjysëm hëne;  
ra në gjirin e një nëne;

Dhe kjo vetë kishte lerë  
në atdhe të xhokës gunës,  
si lind brezi ylyver  
përmes gjirit të furtunës!

E u lidhë me besa — besë,  
loti lashtë u bë vesë,  
u bë ves' edhe pikoj  
u shartoj një vrull fajkuj!

Në saje të kësaj bese  
nëpër gjurmat e një shprese,  
vetëtimthi u hodh çapa,  
katër shekuj mbetën prapa!

Mbetën prapa katër shekuj,  
burra ishim, burra bekuj,  
po sot jemi dhe më ndryshe,  
me shqiponjën ton' stërgjyshe.

Edhe bujku më i vrari  
na u bë hero ugari,  
tejpërtej shqiponj' shqiptari,  
sa dhe hasmin më të marrë,  
di ta pres' me këmb' të parë,  
u rilind Çelo Picari!

Prandaj bën' këto që bënë  
dhe në male thik e borë  
dy pëllëmbë nënë hënë,  
shkolla jonë vuri dorë,  
kullot deshët me këmborë!

I kullot e i kullot,  
në mal zot e në fush' zot,  
zot në mal e zot në fushë,  
vazhdimisht me shpres' të plot,  
vazhdimisht dhe më e fortë,  
Shqipëria vuri gushë!

Dhe arriti sa që ty  
të të thot' i madhi hy:  
ty të duhen njëqind vjetë  
që të bëç një palo pyll,  
un me dorën time vetë  
kam ndërtuar një gexha yll,  
mëmédheun ton' të bukur  
vetëm brenda dyqind muaj,  
kur ish fjala shkenc' e huaj  
edhe hasmi më kish ndukur!

Po tani me gjak në deje  
dhe me vrullin në beteje,  
pa mos pritur gjë prej teje,  
po krijoj njerin e ri!

Po krijoj njerin e gjallë,  
Nëpër gjurma të lajthitur  
gjeta djersën e grabitur,  
ndeza palcën tonë të situr  
dhe i vura yll në ballë!

## TË GJITHË NË VLORË!

Pesëdhjetvjetori tash  
po na gjen si shkëmb i gjallë,  
lart e lart me qindra pash,  
ku dhe vet' shqiponja vetë,  
nuk arrin të vij' vërdallë!

E pra, eja ta festojmë  
madhërin' e kësaj dite,  
Nuk është festa e një dite,  
se dikur këtu në Vlorë,  
dor' e plakut të pavdekshëm,  
ky altari i paprekshëm,  
na pat sjellur amanetin  
e herojve arbërorë!

Pra, të gjith' të gjith' në Vlorë,  
në syt' lotët për dëshmorë,  
në goj' hymnin popullor,  
dhe për nder të kësaj feste,  
le t'i ngrem' dollit me teste!

## N J Ë F L A M Ë

(një spiuni)

Ësht një flamë, Zot o Zot,  
flam' e madhe, flam' e ligë,  
zemra sterr e shpirti shtrig.

Njerëzia deri sot  
s'kishte par' të till njeri,  
pa mëshir', pa vetëdi.

Ky nuk paska shok në botë.  
aq i poshtër, aq i ndyrë,  
i pabes' e i palyrë!

Të bën keq, se është' i lik,  
jo për ty që s'të ka mik,  
po për ty e për të tjerë,  
është' një gjarpër me dy krerë!

Ësht' një' gjarpër mbi gjarpenjë,  
gjuh' e tija helm e vrerë,  
pun' e tija lenjë e tenjë!

Mos ja zini emrin ngojë,  
edhe emri të kafshon,  
të shajton e të helmon!

Vlorë, 1917.



## KËNGËTORI FAT-FARMAK

Një njeri, një varfanjak,  
thar' e thyer në varfëri,  
ky Mamaqi fat-farmak  
ish njeri si asnjeri!

Me një thes me libra dënga,  
një kothere buk' të that'  
dhe një pallto të pamënga  
der më der' e fshat më fshat!

Mirpo librat që përpishte  
në shkëmbim me lugë çape,  
ishin sulme trimërishte,  
ishin prush' i një etape!

Ishin ura, ura zjarri  
nëpër vatra të barotit,  
ish rënkim i një të vrari  
në atdhe të Kastriotit!

Ky njeri si asnjeri,  
sado s'kishte dituri  
i shërbeu dituris,  
dyoind libra mbi kurris!  
E prandaja, brez i ri  
ta kujtoj me dhëmshuri,  
trubadur e vegjëlisë!

## ALI PASHA TEPELENA

Nga satrapët më satrap  
nga dervishët më dervish.  
ky zabit, ky dreqo — lab,  
pa kalem e pa qitap,  
paskish lindur me këmish!

Po satrapin, unë ju lus,  
mos ta marrim për qortim,  
ai ish një kryetrim,  
një rrufe një vetëtim,  
që i tha sulltanit sus!

Një rrufe.....  
po rrufeja, vini re,  
i ka rrënjët në një re!  
si dhe truri tungjatjeta  
me gjith dritëzat e veta,  
i ka rrënjët në kaptinë!  
Po sa larg dhe se sa lart  
shkon e ndrin e vetëtin'!

Dhe Ali Pasha kajmeni  
nip stërnipi i një dere,  
soj dervishi, soj sejmeni,  
i ushqyer me mëna ferre!

Me guximin mrekuili  
u bë kryefermanlli,  
dhe nga truall i tij i ngusht'  
i lëshoi një goxha grusht;  
perandorve Osmanlli!

Dhe arriti sa pothuaj,  
në tryeza të çezarve  
ku vlon hymni ngadhnjimarve,  
hymn' i tija s'mbet i huaj!

Le t'i ngrëm', pra, një dolli!

Fam' e tija është e madhe  
vler' e tija më e madhe!  
Në e ultë historia,  
di ta ngrerë Shqipëria,  
sepse trimin, nuk e nuk,  
trimi trimin nuk e zhduk.

7 PRILL 1939

Shtatë Prill.....  
Kapilove o kopil  
e u lute u këpute  
njëqint pash në dhe u fute!

Natyrisht një tradhëtor  
spor e fisit arbëror  
e pret hasmin me dauille,  
kur gjen ditën ta beni pulle!

Na e gjeti dhe na ra,  
vret Shqiponjën që s'u vra,  
nuk u vra dhe nuk do vritet  
posht përpjet me vrull vërvitet!

Ja dhe hymni që na thuri,  
hymn' i zi i një qivuri:  
«Eja eja allala  
të na rrojë Duçëja  
Duçëja guguçëja,  
le të rroj' edhe flamuri  
sa për sy e për bela!»

I pabesi ta dij, pra,  
ndër kasolle me një tra,

qe nga Shkodra gjer në Dropull,  
rron ai që i thon' popull!

Ajo dor' që rreh dybekun  
di ta mbush edhe dyfekun,  
në se ditën çan ugar  
ajo natën thur litar,  
thur litar e kalit grushtin  
dhe e var nga këmbët pushtin!

— 1939 —

KOKA BËN E KOKA VUAN, Ç'KE MOJ  
ZËMËR QË RËNKON!

Njëher' varet trikollori, herën tjetër kryq' i  
thyer....  
paska rar' hallva nga qielli e ja nis një  
dallaver,  
mbushen xhepet me flori  
e qinosen ujk e dele për të bër' një stan të  
ri!

Shitet vendi për para, me para e për para  
bënet burri telendi, dy para një maskara,  
para hasmit peqe-lepe  
para zërit të atdheut hund' e tyre shtatë  
sqepe!

Duke bler' e shitur erë dikush bënet milioner,  
kurse shoku pinte uthull lum zotria pinte  
verë....

milioneri yn' i ri  
para shokut të dikurshëm vari buz' edhe turi!

E përhera me dy faqe, që të haj e që të bluaj,  
në një kohë mbi dy frona, në një çast e mbi  
dy kuaj,

me dy faqe, me dy nofla, në një xhep e dy  
e hedh këmbën me daulle edhe Turk edhe Kaur!  
flamur

Na të urt' e të mëndafshtë s'qem të zot të  
kur fillon' me thash' e theme hij' e vetes të  
bënim zë,  
përze;  
neve ndryshe, puna ndryshe, defi ndryshe  
kënga ndryshe,  
e ç'kërkon në gji të gjëmbit të këndoj' një  
dallandyshe?

Mirpo vendi paskish zemër, paskish sy e  
shikon lark e dëgjon' thellë, di të vesh edhe të  
paskish vesh,  
zvesh,  
tani eja e t'ja themi asaj kënge që ja thonë:  
Koka bën e koka vuan, ç'ke moj zemër që  
rënkon!

1946

## FLAMURI KOMBËTAR

Kurse erret dor' e Zotit, na ndez Yjet nëpër  
qieje;  
Vala jote madhështore na ndez gjakun në  
beteje

Vala jote madhështore,  
Tregon armët arbënore;  
Ngjiv' e kuqe tregon sheshit,  
Tregon gjakun e arbreshit.

\* \* \*

Tregon gjakun e arbreshve, faqebardh' e  
çepezes,  
Për të mbajtur ty mbi supe, van' u thyen të  
gjith' në mes;

Që të gjith' në mes u thven;  
Po kujtim i tyre vlen,  
Vlen sa syri mu në ballë  
Për një Komb që është' i gjallë.

\* \* \*

Ti je tash nga dor' e tyre, më i madhi amanet;  
Amanetin — thot' arbreshi — edhe toka nuk  
e tret;



Sa të rroj' e sa të jetë,  
Gjir i qiellit plot me yje,  
Ty shqiptari do të ketë,  
Si ka diellin përmbi krye;  
Si ka diellin si ka hënën,  
Mu si nëna që ka djalën,  
Mu si burri që ka fjalën.

\* \* \*

Deri dije një shqiponjë, bij' e mbes' në gur  
të that',

Luft' me sqep e luft' me thonjë, luftëtare me  
të shtat';

Deri dije një shqiponjë,  
Luftëtarë me të shtat;  
Tash e tutje rrofsh si zonjë,  
Të buroft' nga buza mjalt'.

## MIR' SE ARDHËT<sup>1)</sup>

Mir' se ardhët burra trima,  
ju rrufera vetëtima,  
iu fytyra të florita,  
sy o sy me shtatë drita!

Dora juaj, ajo dorë  
kordh' e shkabës dykrenorë,  
diti shkrepë shkrepëtiti,  
diti bukur e goditi  
pra, nga lind e perëndon  
nami juaj po gjëmon!

Që nga koh' e Kastriotit  
Nuk ish thën' nga an' e Zotit  
të kish dalë edhe një bres,  
po kështu me këtë bes,  
dhe për shkabën dykrenorë,  
që të zinte qiell me dorë!

Ju u zutë, bres pas brezi  
dora juaj do ta ndezi,  
do ta bëjë flak' e zjarr

---

1) Kur hyri ushtëria shqiptare në Vlorë.

gjithë kombin shqipëtar,  
do thot' burri më i lartë  
ah të isha i Vlonjatë!

Kështu thonë dhe do thonë,  
si rrufeja që qëllon  
edhe era suferinë  
që bën kuje ulërinë,

Edhe reja që rënkon,  
edhe pika që pikon,  
edhe bora aq e bardhë,  
edhe valët radhë radhë,  
edhe hëna edhe dielli,  
ç'ka në gji që i mban qielli.

Deshëm Vlorën, Vlora rroftë,  
me flamurin rroft' e qoftë  
Vlora jonë, Vlor' o Vlorë,  
Deh të lumtë ajo dorë!

*Vlorë, shtator 1920*

## D Y R R E P E T

Këng' e lasht' e pleqëve  
na tregon një rrap të vjetër  
një kujtim të hidhur tepër.

Ky është rrap i Bilbileqve  
atje afër karakollit,  
rrrotull zhurm' e dymbeleqve,  
me dekret të Anadollit  
vari bekujt e dyfeqve!

Këtij rrapi të mavrisur  
tani lën' si gun' e grisur,  
më von' rrapi Mashkullorës  
ja dha gjegjen hak e sak!

Vret Bimbashin me bajrak  
pararojën e kurorës  
të kurorës turkoshak!  
Dhe ja bëri peshqesh Vlorës  
që ta kish i madhi plak  
dy her bomb' një bomb të dorës  
kundra hasmit dredharak!

## TOL DELJANI<sup>1)</sup>

Një kaçak nga Elbasani!  
jo kaçak si çdo kaçak,  
një kaçak, që shumë a pak.  
e ka njohur jatagani!

Ky është' Toli, Tol Deljani!  
Pati bër' armiq dikur  
disa turq e ca kaur  
që s'u bënej dot dermani!

Një dit', s'dihet kur dhe si,  
ja hip kalit për në Durrës,  
i thon' ndalu, sepse udhës  
të kan' ngrehur një pusi!

Toli sheh se afër tia  
udhëtonin dy — tre pleq  
me dy foshnje mos më keq  
të rrëgjuar nga uria!

---

1) — Treguar nga i ndjeri Prof. K. Cipo

Toli zbret e u thot' pleqve:  
A m'i jepni foshnjët mu  
që t'i mbaj mbi gjunjë këtu,  
mbi gjerdanin e fishekve?

Paç uratën... e kështu  
mbi gjunjë foshnjët që të dy  
dhe qeleshën përmbi sy,  
Tol Deljani hundën hu!

E ja, ja, pusi e parë!  
Një pusi me tre dyfeqe,  
Toli shkon pa gjë të keqe.  
a thu' Toli është i marrë?

Pak më tej pusi e dytë  
dhe pusia më e keqe,  
tri kobure pesë dyfeqe,  
ktheu Tol të plaçin sytë!

Tol Deljani s'është i marrë  
as që sytë i paskan plasur,  
po e di dhe është argasur,  
s'vret shqiptari një shqiptar,

një shqiptar që ka me vehte  
ndonjë foshnjë, ndonjë grua!  
ndryshe, pushka u çnderua...  
edhe bota s'është në vete!

Kështu thoshte Tol Deljani  
kurdoher' e në çdo rast,  
pra, poet akcili Filani,  
i dhuron një «ndjesë pastë»!

## LE T'JA THEMI PËRSËRI

Le t'ja themi përsëri  
këng' o këngë e dashurisë,  
urdhëron filiz i ri  
fjala është e rinisë!

Frym' e shekullit njëzetë  
s'ka të bëj' me fise qielli,  
dy miliar e më shumë vetë  
tani quhen shtetas dielli!

Zoq e zoga leri le  
si u teket po qëndisen,  
musi yjet hergjele  
që në qieje arratisen,  
ven e vin' e gudulisen!

Ideali tyre paqe,  
pun' e paqe, dhe prandaj  
ku dhe trepet bënen parqe,  
ku qesh gropëza në faqe,  
ujku bombën që ta haj!

Ujku bombat nëm e gjëmë!  
këto pote kapitali

rrym' e frym' farmak çakalli,  
fund e krye duhen zhdukur,  
ndryshe bënet byk në lëmë  
tejpërtej kjo bot' e bukur!

Pika dorës që s'i ra  
që kurdis pusi në qieje,  
djek fakir' e fukara,  
dhe përdheshet me një tra,  
sharton vdekje nëpër deje!

Edhe un kam një përdhese  
dy të tretat e një pjese,  
që e quaj një prokopi,  
lëmë pra, të puth të pi,  
të shijoj me stil të ri,  
né shqiponjën Shqipëri!

Lëmë le, pse doemos  
sot a nesër un do sos,  
dhe do bënem fije bari,  
ose plis' i një ugari,  
ose flet' e një hardhie  
do më ndukë një dhëmb' dhie!



«GOC' E RE DHE VER E VJETËR»

Goc' e re dhe ver' e vjetër,  
Kapi urat e cingrasi,  
Kapi vajzat e cimbisi,  
marën flak edhe më tepër.

Me ver' dehe, me goc' çele,  
Si të shprehem nuk e di,  
Fol, mor kadi efendi,  
fol për bes', për perëndi,  
ti me goça a u vele?

\*\*\*

Tregon libri — thot' kadiu, —  
Sollomon i madh profit,  
kishte shije mbinjeriu  
dhe martohej dit' për ditë.

Në harem të tija pra,  
Në haremin më qiellor,  
grumbulloi njëmijë gra,  
Treqind ishin me kuror',

Shtatëqind bërthama prushi  
si meze për raki rrushi

në çdo orë e në çdo rast  
i shijonte lavdi pastë!

Sidomos, më së fundi,  
diti mirë se si e tundi  
mori vajzën Faraun,  
principeshën e Misirit!

Thelb o thelb i xhevahirit!  
Tash, përse fakiri un'  
të mjaftoj me dy që kam,  
njera ethe tjetra flamë?

\* \* \*

Rroft' e vjetra, — thot' Kadiu, —  
me haremet mbushur dënga,  
po jazek haremi vate!  
Rroit' e reja — thot' i riu, —  
dashuria, gazi, kënga  
ti i qaj ato që pate!

## HODO QORRI

(ndodhi anekdotike)

Kusëri e kusëri  
dy hile një trimëri!  
Quati një natë m'u tek  
garth më garth e shtek më shtek  
hop, u futa në një vath,  
zura një milor të math,  
një milor që, pa shaka,  
ish i rëndë sa një ka. —

Nata ishte gjisht në sy,  
unë një dhe dreqi dy,  
hop në sup në një shpellë  
dhe e shkova në një hell.

Quati, i dashur mik,  
kryeplaku, burr' i lik,  
lajmëroi prokuror  
një poturezi në Vlorë  
që ka humbur një milor.

Erdhi pyeti prokurori:  
e kush është ky hurr bir horri?  
E kush qënka ky hajdut,  
që guxoi edhe u fut  
në atë kope me dhënë  
tre dylmer me katër qën?

Mbase është Hodo Qorri?  
Hodo Qorri më thonë mua,  
asgjë s'kam e as gjë s'dua,  
vetëm kam një mavri grua  
haje ujk e në përrua,  
mar dy pal opinga hua  
e i vesh ashtu si dua,  
si ma do nevoja mua,  
Hodo Qorri me një sy  
sheh sa ujku që ka dy.

Pra, kur vete kusëri,  
dy hile një trimëri,  
Me t'u qasur ndonjë vathi  
vesh opingat për së prapthi,  
maj e këmbës mbetet pas  
gjurmën time e humbas.

Ja kështu e bëra prëmë,  
këtu tham, këtu e lemë,

Flet qatipi prokurorit  
— Nuk është gjurm e Hodo Qorrit!  
kemi shpirt e kemi zemër,  
dhe, sado që të rri shtrembër,  
them të drejtën dhe këtu  
e vërteta ja bën: mu!

Ky do jetë kryeplaku!  
Krisi me gazep dajaku.  
kryeplaku kurdohera  
bën të tilla dallavera.

Fundi fjalës, more bir,  
un' e bëra qelepër!

## VAJZAT TONA DHE MOTRA HËNË

Në udhtim të saj në mbramje  
hëna jon' e ka zakon,  
me atë të bukur pamje  
madhërisht kalon e shkon!

Kur fle dielli dritflori,  
Hëna kthehet përsëri,  
sidomos këtë hëna  
në të këndshmen Shqipëri;  
sepse hëna  
Është motra, zër' o zërë,  
e guguçeve shqiptare,  
ajo është që i ka bërë  
vajzat tona kaq krenare!

Vajza jonë paska lerë  
kalaqaf mbi ylyver,  
dhe, sado që me shumë shije  
dhëmshurisht ndër këmb të bije,  
di të bëj' si bën një hije:  
iu afrove nuk të qas,  
iu largove të vjen pas!

Në se fole nuk të flasën,  
në mos fole zën e shkasën,  
dhe me cep të syrit, tak,  
flak për flak,  
me atë të shkret vështrim,  
të qëllojnë edhe të vrasën!

Sedr' e tyre, hak e sak,  
sepse jan' krijesa flak';  
leri pra të bëjn' si bën  
nuse qiellit, motra hën'!

Hëna duket edhe zhduket,  
her' me dhëmb' të natës nduket,  
e hollonet e hollonet  
saqë bënet vetull syri.  
her' kullonet e kullonet  
bënet thelb i një bilyri!

Për këto që shkon e bënë  
bot' e qiellit nusen hënë,  
kurr' e kurrë s'e kanos,  
as që kurr' e ka kanosur;

E prandaja qesh e los,  
drit' e saja s'ka të sosur!

Po kështu dhe vajzës vëndit,  
kësaj ajke të ergjëndit  
prapaniku i damkosur,  
s'mund t'i thotë: ktheu prapa!  
lere dasmën, shko për shkarpa!

## SOT JU FLAS SI BABAGJYSH

Një i ri, një këngëtor,  
ju pat thurur një tuf' këngë,  
po atje në atë Vlorë,  
ja kish bërë koka dëngë!

Ato këng' në gjuh' të gjyshes  
u bën' hymni i burrnive,  
u bën' hymn i dallandyshes  
u bën' hymni i hyjnive!

Ai, ish i riu i shkret',  
vjetëruar e thyer më dysh,  
pas dyzet e disa vjet  
sot ju flet si babagjysh!

Flas me ju, moj dallandyshe  
përsëri e përsëri,  
sado plak, po fare ndryshe,  
kam në shpirt një dell të ri!

Më pëlqen të flas me goca,  
Këto goca arbërore,

më shumë vjollca nga vetë vjollca  
dhe nga vera më verore!

Dhe ju flas me zjarr në gji,  
me gjysmakun zjarr që mbeti,  
sepse flaka ime fjeti,  
kam një këmb' në yzengji...  
jam udhtar eterniteti!



## PËR T'JU FALUR BUKURISË

Kur më vete, kur më vjen  
më rrëmben e më rrëmbush, më rrëmbush e  
më rrëmben:  
ti përher' e përgëzuar dhe e tëra fllad e fletë,  
un' përher' i gjunjëzuar dhe i tëri pal' e petë!

Kur më vjen e kur më vete  
edhe hijen them ta mbleth dhe ta mbaj në  
hijen tënde, frymën tënde përvëlonem që ta  
përvëlonem që ta thith dhe vështrimin që më  
gji për vete...  
mbleth,  
heth!

Vidi, vidi pëllumbeshë,  
para teje vij e falem me gjith' zjarrin tim  
dallandyshtet, që në dimër nuk e dim' ku ven'  
dhe ato që prej së largu për ju vajza për ju  
rrebesh,  
e futen,  
luten...

Për ju falen, për ju luten,  
për t'ju falur bukurisë digjen yjet dhe këputen!

SHTATËDHJET E DY MIJ' VAJZA QËNKA  
PJESA E NJË BURRI!

Nëpër libra përrallore që dikur kan rar' nga  
qielli  
është shkruar ferman i hyjve me kalem prej  
shtizash dielli:  
Kryehyu është i bukur dhe të bukurën e do!  
Shtatëdhjet e dymij' botë iu përgjegjën qiellit:  
po!

Urdhri tija është mbi krye me kuptimin më të  
gjërë,  
i pa prerë me gërshërë, i paqepur me gjilpërë.  
E kështu ja nisi këngës një bilbil finos finos...  
Trëndafil, o trëndafil, më pëlqen me ty të los!

E këndoi Ademi Evën, e këndoi dhe bleta lulen  
dhe poetët — besnik' qielli — vajzave në  
gjunj' iu ulën,  
zogu zogën, flladi fletën, vala valën e vijojo...  
Ler' ta kapi, ler' ta puthi, ler' ta pi e ta  
shijoj!

Këtij urdhri kaq të ëmbël i paudhi s'iu përul,  
dhe në tru të fanatizmës ngrehu fronin e u ngul;

duke folur me fjal' feje përmes gojës së një  
na ka bër kuben e qiellit si tavanin e një  
murgu  
burgu!

Çdo të bardh' e bën të zezë, çdo të zezë, më të  
zezë,

na i plasi sy e zemra po sa nisën e u ndezë:  
e na bëri sa i flakëm gjith' hyjnit e bukurisë  
e u çmendëm tej përtej, i bëm' luftë dashurisë!

«Sakën vajzën mos e puth, sakën verën mos e  
pi!

Bota jonë qënka burg, këtu s'paska prokopi...  
Kur të vdesëm e pastaja poezia që na thuri —  
shtatëdhjet e dy mij vajza qënka pjesa e një  
burri!

Kupa, çupa, kënga, qejfi çdo dëfrim është  
gjynah!  
uj i ftohtë është hallall, vajz' e ngrohtë është  
haram!  
që të kemi gjith parajset me ferman e me tapi  
vajzën kur mos e puth edhe verën mos e pi!

Me të tilla thashe theme,  
shkoj e vajti koh' e rreme!  
Po tani që zbrazet kupa me shëndet e me  
dolli  
dhe në mes të dy gjishtrinjve thyhet vajza mes-  
kalli,  
lumthi ju mor shok e shoqe, tani jeta është e juaj,  
nga këto gostira lulesh tetëdhjet bukshi është i  
huaj,

emri tija bosh një emër  
shih me sy e plas me zemër!

## KUR KAM SYT' E TU TË ZES

O ti syri zi mazi!  
Poezinë, atë verb  
un' nga syri yt e gjerb,  
nëpër dhelkëza vështrime  
rrëmbej artin e një rime,  
rrëmbej rimën e një arti  
dhe si yti, më i zjarrti,  
përgëzonem prej së larti.  
Përgëzonem or' e ças,  
nga një bot' në tjetrën shkas,  
rreth për ty me djellin flas!

Flas për ty, kur flas për Zotin,  
si e ka stolisur lotin,  
atë lot, që më ka hije,  
kur në këmb' të tua bije!

— Poezi e një poeti!  
— jo, jo, këng' eterniteti, —  
mbushma gotën dhe një herë,  
po të lutem rrafsh e prerë!

Un' kam vjershën edhe pijen  
po je ti, që u jep shijen,  
pija ime, shija jote,  
un' i gjithë hija jote!

Gugu-gugu, guguftuja,  
mos më pyet sa gota dua,  
kur kam syt' e tu të zes  
buzës s'ime s'i zë bes'!

## MBI QEPALLË MË TROKITË

Mu këtu,  
ku ormisi zëmrën Zoti,  
aty kam një guguftu,  
që e koj me pika loti.

Natën vjen' e bënet dritë,  
bënet dritë e bënet yll,  
mbi qepalle më trokitë,  
s'më lë syrin që ta mbyll.

Ditën bënet vetëtimë  
e me krisma e me bujë,  
shkrep në mes të shpirtit tim  
dhe më prish, më bën rrëmuje.

Iki larg e ngrihem lartë,  
kaloj drit' e kaloj hije,  
pastaj zë e flas përçart  
dhe në këmb' të saja bije.

E kudo që ajo vete  
më tërheq si hije pas,  
Zot, o Zot që s'jam në vete,  
e humbas, humbas, humbas...

Dhe buças si val' mbi zallë,  
kur buçet e kur dremit,  
ajo vjen përher' vërdallë  
mbi qepalle më trokit.

## VETËM JETA S'MUND TË MATET

Dhe ajo që m'u duk mua e përhershme shkoj e  
vate,  
Vate jeta ime vate, më la vetëm një kujtim.  
S'di, i ziu, ç'është' kujtimi: vetëm shkrep si  
vetëtim  
e më ndrit e më tregon gjurmëzat e zotris'  
sate.

Thonë lindi me këmishë, për atë që paska  
fate,  
me që unë të dua ty, paskam lindur me  
këmish',  
s'di, i mjeri, ç'është' këmisha, vetëm ish ashtu  
si ish,  
midis mishit dhe këmishës futej dor' e zotris'  
sate.

Thonë paska paraise, gjith' lulishte e pallate,  
tufa tufa me hyrira, vargje vargje me kumrira,  
s'di, i ziu, ç'është' hyria, por hyrirat më të mira  
s'mund ta ken', t'u bëfsha unë, atë zjarr të  
zemrës sate.

Paska vënde gji-ergjënde e pallate me shtat  
pate,  
ku ka defe, ku ka qejfe, ku ka çupa me kaçupa,  
s'di, dhe s'di, se ç'është' kaçupi, më pëlqen më  
tepër kupa,  
kur ma mbush e kur ma jep ajo dorë pa  
mëkate.

Dy të tretat e një kohe, të një shekulli që vate,  
vate jeta ime vate, me 'të bashkë van' dhe  
fatet,  
s'di, i ziu, se ku vanë, vetëm jeta s'mund të  
matet  
veç me ditët që kalova në prani të zotris' sate.

## K Ë N G Ë

Yjet qënkan baltë,  
dielli vatër prushi,  
Vajzat mjalt o mjaltë,  
Zoti na i faltë,  
Rrofsh moj raki rrushi!

Pa çup' e pa kup'  
Kjo kaptin' kokalle  
është' e rënd' mbi sup,  
sa dy thas' me halle!

Sado Bab adami  
mundi e na lindi,  
po Omar Hajami  
diti e na bindi.

Qënka mos na qënka  
Fundi, varr i Bamit  
mbetet vetëm kënga  
e Poet Hajamit!



## MBRETËRESHA PERËNDESHË

Kleopatra mbretëreshë  
ti, — i thosh atij që desh, —  
sonte eja rri me mua,  
nesër vdis, pse ashtu dua!

Cilido që ai ish  
quhej lindur me këmish'  
dhe sado që ajo pjekje  
do mbaronte me një vdekje!

S'të pëlqen?

— jo!

—Çudi!

çfar' është' jeta a e di?  
Një pik' prushi në një natë  
me miliarda vjet e gjatë,  
është' një flakëz bukurezë,  
befas falet sa u ndezë...

E, pra, duhet një kujtim,  
që të kap me një rrëmbim  
dhe të hedh mbi sup të flladit  
në të djatht' të hyut fatit,

dhe të tund e të lëkund  
ku gjen Zotin më në fund!

Si nashti.  
un' dhe ti,  
un' poet, ti poezi,  
syri yt ulli i zi,  
atë sy dhe até vetull...  
dhe m'u bëft kurban një shekull!

## DO T'I SHTRYDH TË DY SYTË

Un' jam un', saksi e vjetër!  
Lule gjirit që stolisa shkoi stolisi një gj  
tjetër.

Un' e nisa e stolisa me ç'i jep e s'i jep sisa  
dhe me këngë ylyveri buz' e gushë ja qëndisa.

Nëpër vapëz i dhash' hije, nëpër hije er' e  
shije,  
i dhash' shije poezie, gjith' fuqit' e një magjie,  
gjith ato, që fllad i ëmbël nëpër lule mbar e  
bije,  
ar' e diellit me tallaze, ar' e hënës fije-fije,  
dashuria me dollira dhe me thelp lajthije  
pije...

Po u bë ajo që s'bënej, si, pra, zemra do  
duroj'  
syri lotin ta qëndisë, loti syrin ta harroj?  
Si, pra, zemra do durojë un' saksia tash të  
vuaj  
edhe këngë e gjirit tim të këndo' në gj'i të  
huaj?

Un' e nisa e stolisa me ç'i jep e s'i jep sisa,  
dhe me këngë ylyveri buz' e gushë ja qëndisa.

buz' e gushë ja qëndisa, e ormisa mu në zëmër  
plasi hëna ziliqare që shikonte me sy vëngër!

Më së fundi i dhash' lotin, kryepajën time pajë,  
i dhash' lotët që pikonin ku i shkelte këmbë  
e sajë,  
i dhash' vjershën time valë, dy herë valë tri  
her' zjarr,  
që buçet në maj të penës edhe bënet këng' e  
marr',  
këng' e marr' e mallit tim, që tani e paskëtaj  
do t'i shtrydh të dy sytë nëpër gjurma të  
asaj!

## MOSH' O MOSH', QË MBETE PAS

Për kujtimet s'paska shëmbje,  
paska lot' e paska dhëmbje...  
Në bërtham' të këtij loti  
kërkoj gjurmat e një moti...

Mot o mot, që mbete pas,  
me ty dua që të flas,  
të të vihem pas e pas  
sa të plas e të gajas!

Jam xhindosur nga një mall,  
pra, me syt' që kam në ball,  
nuk vështroj atë që vjen,  
nesër, ditën që më vlen,

po vështroj atë që shkoj,  
dhe kërkoj, kërkoj, kërkoj...  
mu në sqep të një pullumbi  
kërkoj këngën që më humbi!

\* \* \*

Nashti rroj, po ja si rroj:  
Kur shkojn' vajzat bukuri  
i vështroj e i vështroj,

heq kapellën i nderoj,  
varur buz' edhe turi!

Vij vërdallë në shtëpi,  
dhe me qën' se s'jam i zoti  
të punoj, të puth, të pi,  
rrah të vetmen prokopi,  
gruan time kot së koti!

## SIKURSE KISMETI

Sikurse kismetit të më pyeste mua:

«Ti, o bir, çfar' do?»

ku di un' i shkreti, çfar' t'i thoshja  
dua,

po aë, domosdo,  
do kishja ndër mënd  
t'i kërkoj një vënd,  
nja dyzet vreten  
dhe kudo të jen'.

Se nga toka jon'  
dhe flori buron,  
një puçer me far'  
jep dy grushte ar.

Pra, do mbillja pemë,  
s'është' nevoj' t'i themë,  
ç'i tregon me radhë  
shëg' e moll' e dardhë,  
edhe shumë hardhira,  
p'jergulla të mira,

Toka e arbreshit  
ngrohet mir' nga dielli,  
dielli derdhet sheshit,  
vjen peshqesh nga qielli.

Pra, si dimër verë,  
do kishja përherë  
pemët me karroqe,  
lumthi ime shoqe,  
një nga një këput  
edhe hith në futë!  
E kush është më mirë  
nga një jet' e lirë  
dhe asgjë mbi krye  
vetëm... qiell 'e yje?

Jetë për shtat' qeife,  
për këng' e për defe.  
Kënga e bilbilit,  
majës trëndafilit,  
na thotë se jeta  
është' e mirë e shkreta,  
kurse ka një ëndër  
që vjen e të deh,  
kurse ka një zemër  
që për ty po rreh!

1930



## NUK MË JE AJO QË ISHJE

Un të pash' po ti nuk ishe,  
Dikur ti një magji kishe;  
Një magji, një hijeshi,  
Rrez' e diellit nëpër shi.

Një magji, po jo xhan, jo,  
Ish ajo mbi gjith' këto,  
Ra mbi fëmra i pajisi  
Ra mbi zëmra i mahisi!

Kurse thuhet është' e artë,  
Kur nuk thuhet është' e zjarrtë,  
Shijon gazin, shijon lotin,  
Të jep ras e flet me Zotin!

34853

BIBLIOTEKA E SHTETIT  
GJIROKASTËR

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
— Myzeqeja dje dhe sot . . . . .	3
— Thumani . . . . .	5
— Shkoi koha e pallashës . . . . .	7
— Kujtime të vjetra . . . . .	9
— Di ta mundi vdekjen . . . . .	14
— Na tregon njeru i vjetër . . . . .	15
— Vajzat dhe dallëndyshet . . . . .	17
— Shpella e bletës . . . . .	19
— Dyqind muaj edhe t'hu . . . . .	21
— Nusja që do Halla 1) . . . . .	23
— Një altar i madh shqiptari . . . . .	27
— Fshati Vajzë . . . . .	30
— Tepelena . . . . .	35
— Po krijoj njerinë e gjallë . . . . .	37
— Të gjithë në Vlorë . . . . .	40
— Një flamë . . . . .	41
— Këngëtori fat-farmak . . . . .	42
— Al. Pashë Tepelena . . . . .	43
— 7 Prill 1935 . . . . .	45
— Koka bën e koka vuan, ç'ke moj zëmër që rënkon! . . . . .	47
— Flamuri kombëtar . . . . .	49
— Mir'se ardhët . . . . .	51
— Dy rrepet . . . . .	53
— Tol Deljani . . . . .	54
— Le t'ja themi përsëri . . . . .	56
— Goc' e re dhe ver' e vjetër . . . . .	58
— Hodo Qorri . . . . .	60
— Vajzat tona dhe motra hënë . . . . .	62
— Sot ju flas si babagjysh . . . . .	63
— Për t'iu falur bukurisë . . . . .	66
— Shtatëdhjet e dy mij' vajza qenka pjesa e një burri . . . . .	67
— Kur kam sytë tu të zes . . . . .	69
— Mbi qepalle me trokitë . . . . .	70
— Vetëm jeta s'mund të matet . . . . .	71
— Këngë . . . . .	73
— Mbretëresha perëndeshë . . . . .	74
— Do t'i shtrydh të dy sytë . . . . .	76
— Mosh'o mosh, që mbete pas . . . . .	78
— Sikurse kismetit . . . . .	80
— Nuk më je ajo që ishje . . . . .	82